

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 20

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe ortakëve të Shoqërisë United Quarries sh.p.k.

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë United Quarries sh.p.k. (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2015, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.


Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të **United Quarries sh.p.k.** më datën 31 dhjetor 2015, performancën e saj financiare dhe fluksin e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.



Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjakët",
No. 1000, Tiranë, Albania
Tërbërës 42 278 015
www.mazars.al | info@mazars.al

Irena Hoxha (Pulo)
Irena Hoxha (Pulo)
Partner Angazhimi


29 mars 2016

UNITED QUARRIES sh.p.k.
(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	420,455	3,302,295
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	859,218	2,714,319
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	4,619,289	4,619,289
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	10,077,139	10,148,563
Inventari	8	11,558,546	12,250,230
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	73,359	94,699
Total aktive afatshkurtra		27,608,006	33,129,395
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale		179,109,391	188,410,090
Aktive afatgjatë materiale në proces		4,497,834	4,497,834
Total aktive afatgjatë	10	183,607,225	192,907,924
Total aktive		211,215,231	226,037,319
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	4,363	7,008,310
Llogari të pagueshme tregtare	12	3,354,681	12,899,769
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	51,830,540	17,913,479
Detyrime tatimore	14	515,774	535,552
Të tjera detyrime	15	4,661,378	3,610,290
Total detyrime afatshkurtra		60,366,736	41,967,400
Detyrime afatgjatë		-	-
Total detyrime afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		60,366,736	41,967,400
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar		160,000,000	160,000,000
Primi i lidhur me kapitalin		-	-
Rezerva të tjera		11,321,024	11,321,024
Rezerva ligjore		3,544,964	3,544,964
Fitime të mbartura		9,203,931	50,908,931
Fitimi i ushtrimit		(33,221,424)	(41,705,000)
Total kapitali	16	150,848,495	184,069,919
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		211,215,231	226,037,319

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


UNITED QUARRIES
SH.P.K. ELBASAN 2



UNITED QUARRIES sh.p.k.*(Vlerat janë në Lekë)*Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	9,361,200	8,453,712
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimt në proces	18	(690,525)	(2,249,953)
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	94,601	(149,410)
Lëndë të parë materiale dhe shërbime		(11,144,418)	(13,065,666)
1) Lëndë të para materiale dhe shërbime direkte	20	(5,215,564)	(4,325,725)
2) Të tjera shpenzime	21	(5,928,854)	(8,739,941)
Shpenzime të personelit	22	(21,645,354)	(22,831,371)
1) Paga dhe shpërblime		(18,685,231)	(19,897,872)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(2,960,123)	(2,933,499)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23	(9,300,699)	(9,812,028)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(1,060,379)	(20,902)
Të ardhura/(Shpenzime) financiare	25	1,164,150	(2,029,382)
1) Të ardhura/(Shpenzime) interesi dhe shpenzime të ngjashme		1,094,994	(2,097,262)
2) Shpenzime të tjera financiare		69,156	67,880
Fitimi/humbja para tatimit		(33,221,424)	(41,705,000)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		(33,221,424)	(41,705,000)
Te ardhura te tjera gjithperfshirese per vitin:		-	-
Totali i te ardhurave te tjera gjithperfshirese per vitin		(33,221,424)	(41,705,000)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

UNITED QUARRIES
SH.P.K. ELBASAN

UNITED QUARRIES sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015


	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet/Humbjet e mbartura	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2014	160,000,000	3,544,964	11,321,024	68,913,115	(18,004,184)	225,774,919
Transferim në fitime të mbartura				(18,004,184)	18,004,184	-
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:					(41,705,000)	(41,705,000)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014	160,000,000	3,544,964	11,321,024	50,908,931	(41,705,000)	184,069,919
Transferim ne fitime te mbartura				(41,705,000)	41,705,000	-
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:					(33,221,424)	(33,221,424)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	160,000,000	3,544,964	11,321,024	9,203,931	(33,221,424)	150,848,495

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i United Quarries sh.p.k. më ___ mars 2016 dhe janë firmosur si më poshtë.

Hartoi:
Egilda Vyskka

Charles Bouri
Z. Charles Michael Bouri
Administrator

UNITED QUARRIES sh.p.k.
(Vlerat janë në Lekë)
**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi përpara tatimit	(33,221,424)	(41,705,000)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	-	(153,221)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9,300,699	9,812,028
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzimet e shtyra	21,340	135,301
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	1,926,525	(2,184,138)
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme nga palë të lidhura	-	142,858,992
Rënie/(rritje) në inventarë	691,684	2,433,222
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(9,564,866)	(8,962,592)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme për palë të lidhura	33,917,061	(72,352,072)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	1,051,088	744,588
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	4,122,107	30,627,108
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	-	(28,041,225)
Pagesa e huave	(7,003,947)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(7,003,947)	(28,041,225)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(2,881,840)	2,585,883
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	3,302,295	716,412
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 420,455	3,302,295

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

5

**UNITED QUARRIES
SH.P.K. ELBASAN**

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "United Quarries" shpk është regjistruar më 1 korrik 1996 në Regjistrin e Shoqërive me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.38668 datë 27.06.2007.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është prodhimi dhe përpunimi i gurit gëlqeror të fraksionuar, tregëtim i tij etj.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 160,000,000 lekë i cili zotërohet nga :

- Seament Albania sh.p.k. me 137,600 kuota ose e barabartë me 86 % të kapitalit
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes. me 20,950 kuota ose e barabartë me 13.094 % të kapitalit
- Individë të ndryshëm në total 1,450 kuota ose e barabarte me 0.906 % të kapitalit

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë më NIPT, J62904210Q. Selia qendrore e saj është në Rr "Abdyl Frasherit", Pall 11/1, kati i shtatë, Tiranë. Administratori i shoqërisë është Z. Charles Michael Bouri.

Në 31 dhjetor 2015 shoqëria kishte 33 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Euro/Lek	137.28	140.14
USD/ Lek	125.79	115.23

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	5%
Instalime të përgjithshme	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtarinë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollon nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

UNITED QUARRIES sh.p.k.
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
 (Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Mjete monetare në Lekë	202,857	1,511,114
<i>Arka</i>	52	143
<i>Banka</i>	202,805	1,510,971
Mjete monetare në valutë	<u>217,598</u>	<u>1,791,181</u>
<i>Arka</i>	-	-
<i>Banka</i>	217,598	1,791,181
	<u><u>420,455</u></u>	<u><u>3,302,295</u></u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Klientë për mallra	859,218	2,714,319
	<u><u>859,218</u></u>	<u><u>2,714,319</u></u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Llogari të arkëtueshme tregtare nga Fushë Kruja Cement Factory	4,619,289	4,619,289
	<u><u>4,619,289</u></u>	<u><u>4,619,289</u></u>

UNITED QUARRIES sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015
(Merat janë në Lekë)

10. Aktive Afatgjata Materiale

Kosto	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Pajisje Informatike	Pajisje zyre	Aktive ne proces	Totali
Gjendja më 1 janar 2014	4,048,400	189,211,415	275,936,624	53,785,247	451,648	550,295	4,497,834	528,481,463
Pakësime								
Gjendja më 31 dhjetor 2014	4,048,400	189,211,415	275,936,624	53,785,247	451,648	550,295	4,497,834	528,481,463
Shtesa								
Pakësime								
Gjendja më 31 dhjetor 2015	4,048,400	189,211,415	275,936,624	53,785,247	451,648	550,295	4,497,834	528,481,463
Amortizimi i akumuluar								
Gjendja më 1 janar 2014		179,467,412	105,159,892	40,172,349	445,250	516,608		325,761,511
Amortizimi i vitit		487,200	8,538,840	777,660	1,596	6,732		9,812,028
Pakësime								
Gjendja më 31 dhjetor 2014	-	179,954,612	113,698,732	40,950,009	446,846	523,340	-	335,573,539
Amortizimi i vitit		462,841	8,111,895	719,374	1,200	5,389		9,300,699
Pakësime								
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	180,417,453	121,810,627	41,669,383	448,046	528,729	-	344,874,238
Vlera neto kontabël								
Gjendja më 31 dhjetor 2014	4,048,400	9,256,803	162,237,892	12,835,238	4,802	26,955	4,497,834	192,907,924
Gjendja më 31 dhjetor 2015	4,048,400	8,793,962	154,125,997	12,115,864	3,602	21,566	4,497,834	183,607,225

UNITED QUARRIES
SH.P.K. ELBASAN

Charles Dauri

14

11. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Huamarrje afat shkurtër - Raiffeisen bank	4,363	7,005,987
Te tjera		2,323
	<u>4,363</u>	<u>7,008,310</u>

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Furnitorë	3,098,777	12,655,468
Furnitorë për fatura të pambërritura	255,904	244,301
	<u>3,354,681</u>	<u>12,899,769</u>

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Elbasan Cement Factory	50,620,249	13,914,942
Seament Albania	1,210,291	3,998,537
	<u>51,830,540</u>	<u>17,913,479</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	437,769	408,142
Tatimi mbi të ardhurat personale	78,005	127,410
	<u>515,774</u>	<u>535,552</u>

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Paga për tu paguar	4,545,878	3,530,790
Te tjera detyrime ndaj punonjësve	115,500	79,500
	<u>4,661,378</u>	<u>3,610,290</u>

16. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 160,000,000 LEK dhe zotërohet 100% nga ortakët:

- Seament Albania sh.p.k. me 137,600 kuota (86 % të kapitalit)
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes me 20,950 (13.094 % të kapitalit)
- Individë të ndryshëm në total 1,450 kuota (0.906 % të kapitalit)

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Numri i kuotave	160,000	160,000
Vlera nominale (në LEK)	1,000	100,000
Kapitali themeltar	<u>160,000,000</u>	<u>160,000,000</u>

Rezerva ligjore nuk ka ndryshim nga viti paraardhës, dhe paraqitet në shumën 3,544,964 Lekë.

Rezerva të tjera nuk ka ndryshim nga viti paraardhës, dhe paraqitet në shumën 11,321,024 Lekë.

Shuma prej 9,203,931 Lekë përfaqëson fitime të mbartura nga viti paraardhës.

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga shitja e gurit gëlqeror	9,361,200	8,453,712
	<u>9,361,200</u>	<u>8,453,712</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne	
Qarkullim i tatueshem	9,361,200
Shuma e qarkullimit e korrektuar	9,361,290
Sipas Kontabilitetit	9,361,200
Diferenca	<u><u>-</u></u>

18. Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces

Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	(690,525)	(2,249,953)
	<u>(690,525)</u>	<u>(2,249,953)</u>

19. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen 17im ë poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare	202,737	352,022
Shpenzimet nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare	(108,136)	(501,432)
	<u>94,601</u>	<u>(149,410)</u>

20. Lëndë të para materiale dhe shërbime direkte

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme dhe shërbimet detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Materiale ndihmëse	34,181	266,067
Lëndë djegëse	76,776	246,214
Shpenzime për energji dhe ujë	2,939,829	2,242,838
Shpenzime transporti	1,696,718	1,147,920
Taksa minerare	468,060	422,686
	<u>5,215,564</u>	<u>4,325,725</u>

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Mirëmbajtje dhe riparime	13,000	73,000
Sigurime	482,385	575,778
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	121,290	101,160
Komisione bankare	58,862	204,701
Taksa dhe tarifa vendore	1,495,645	1,456,158
Konsulenca dhe shërbime nga të tretë	3,589,800	5,348,811
Të tjera	167,872	980,334
	<u>5,928,854</u>	<u>8,739,942</u>

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Pagat dhe shpërblimet e personelit	18,685,231	19,897,872
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	2,960,123	2,933,499
	<u>21,645,354</u>	<u>22,831,371</u>

Numri i punonjesve më 31 dhjetor 2015 është 33.

23. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	9,300,699	9,812,028
	<u>9,300,699</u>	<u>9,812,028</u>

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penaltitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Gjopa dhe dëmshpërblime	1,060,379	20,902
	<u>1,060,379</u>	<u>20,902</u>

25. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime për interesa	(94,316)	(2,097,375)
Të ardhura nga interesat	1,189,310	113
Të ardhura të tjera financiare	69,156	67,880
	<u>1,164,150</u>	<u>(2,029,382)</u>

UNITED QUARRIES sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	(33,221,424)	(41,705,000)
Shpenzime të panjohura	1,060,379	20,902
<i>Fitimi para tatimit (përfshire shpenzimet e panjohura)</i>	(32,161,045)	(41,684,098)
Humbje fiskale e mbartur	(59,435,070)	(17,750,972)
Humbja fiskale e vitit	(91,596,115)	(59,435,070)
<i>Tatim fitimi @15%</i>	-	-
	<u>(33,221,424)</u>	<u>(41,705,000)</u>

27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>		<u>31 dhjetor 2014</u>	
	<u>Të arkëtueshme</u>	<u>Të pagueshme</u>	<u>Të arkëtueshme</u>	<u>Të pagueshme</u>
Seament Albania	-	1,210,291	-	1,210,291
Elbasan Cement Factory	-	50,620,249	-	16,703,188
Fushe Kruja Cement Factory	4,619,289	-	4,619,289	-
	<u>4,619,289</u>	<u>51,830,540</u>	<u>4,619,289</u>	<u>17,913,479</u>
	<u>31 dhjetor 2015</u>		<u>31 dhjetor 2014</u>	
	<u>Shitje</u>	<u>Blerje</u>	<u>Shitje</u>	<u>Blerje</u>
Elbasan Cement Factory	11,233,553	133,202	760,000	351,242
Fushe Kruja Cement Factory	-	-	-	16,949
	<u>11,233,553</u>	<u>133,202</u>	<u>760,000</u>	<u>368,191</u>

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përfaqësuara me ato të tregut.

24. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2015 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.